

Marenglen VERLI

Jasharajt - produkt i një vatre patriotike

Jemi sot këtu pas 20 vjetësh nga qëndresa e padëgjuar dhe e pashembullt e Adem Jasharit dhe nga akti sublim i një familjeje të tërë. Ajo që ndodhi, që tashmë është e njohur nga të gjithë, ishte diçka përtej reales, ishte në kufijtë e fantazisë, ishte një legjendë, prandaj pati efektin e rrufesë. Ajo që ndodhi ndezi dhjetëra e mijëra zemra, i dha popullit të Kosovës besimin se liria mund të arrihej nëse për të luftohej me vetëmohim, por i dha edhe botës një mesazh të fortë se shqiptarët nuk mund të toleronin më tej të shtypeshin, të mbaheshin në robëri, të maltratoheshin. Nuk mund të ndodhte kjo në një kohë kur mbyllej shek. XX, e Evropa propagandonte respektimin e standardeve të larta të civilizimit, të lirisë e demokracisë.

Pas epopesë së Prekazit shqiptarët u bënë bashkë kudo që ndodheshin, shtrënguan radhët për të bërë detyrën ndaj kombit dhe atdheut, kurse faktori ndërkombëtar u zgjua nga letargjia dhe burrat më vizionarë të shtetit në SHBA dhe Evropë u vunë në veprim për të korrigjuar në rrethana të reja historike, gabimet e paraardhësve dhe neglizhimin për shumë kohë të çështjes së Kosovës.

Sot ne jemi këtu, sepse, në këto 20 vjet, nga koha e sakrificës heroike të marsit 1998, shumë çka është transformuar, sepse Kosova është shtet i pavarurë i njohur masivisht në botë, por, duke qenë këtu, ne mund dhe duhet të bëjmë edhe një vështrim retrospektiv se përse ajo flakë shpërtheu pikërisht në Prekaz, pikërisht në Drenicë.

Drenica nuk ka pasur shumë popullsi, as shumë potencial ekonomik, krahasuar me vise të tjera të Kosovës, por padyshim ka qenë një vatër qëndrese në të gjithë periudhat e historisë, kur dallgët e pushtimeve e ripushtimeve kanë vërshuar mbi viset shqiptare. Në qendër të Kosovës ajo ka rrezatuar në të katër anët forcë qëndrësë e patriotizëm. Nëse nuk do të zhyteshim thellë në histori për të kërkuar në Drenicë, në burrat e saj luftëtarë, ajkën e ushtrisë dardane, apo më vonë korpusin e zgjedhur të armatës ballkanase, që u ndesh në betejën e famshme të Fushë-Kosovës në 1389 me ushtrinë e fuqishme osmane të Muratit, në mos për të identifikuar aty edhe Milloshin e shumë diskutuar për përkatësinë etnike, vrasësin e sulltanit osman, do të konstatonin lehtësisht se gjatë dy shekujve të fundit Drenica spikati si qendër e qëndrësës, e luftës për liri, për të drejta sociale, për autonomi e pavarësi.

Bushatlliu i fundit, veziri i Shkodrës, kur shkonte të sfidonte Portën e Lartë në Përlepe Babunë, në dekadat e para të shek. XIX (1831), kishte përkrahe dhe burrat e Drenicës. Udhëheqësit e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, edhe kur luftohej për Plavën e Gucinë, kundër ushtrisë malazeze, por edhe kur më 1881 i kthenin armët Dervish Pashës, mbështeteshin te drenicakët. Lidhja më së fundi u shtyp nga Porta e Lartë, por Drenica, edhe më tej, as armët nuk i dorëzoi as taksa e ushtarë nizamë nuk dha.

Gjatë viteve 1887-1893 kryengritësit e Drenicës ishin përsëri në këmbë, për të kundërshtuar abuzimet e administratës osmane dhe përprjekjet e saj për të mbledhur taksa aty ku s'kishin investuar asgjë dhe ku ekonomia ishte në nivelin e mbijetesës. Kurse rreziku i jashtëm i bashkoi gjashtëvjet më vonë drenicakët (më 1899) rreth Haxhi Zekës dhe Lidhjes së Pejës së drejtuar prej tij.

Në fund të shkurtit dhe në fillim të marsit 1900, qindra kryengritës të zbritur nga Drenica hynë deri në periferinë e Prishtinës duke kërkuar largimin e mytesarifit dhe funksionarëve të tjerë osmanë nga qyteti. Dy vjet më vonë, në tetor 1902, Shemsi Pasha depërtoi e dogji fshatra të tërë në Drenicë, që kishte bërë kauzë me Isë Boletinin për të mos lejuar çeljen e konsullatës ruse në Mitrovicë, për shkak të politikës destruktive të Rusisë në rajon. Një vit më pas situata agravoj përsëri. Drenica mbështeti krerët atdhetarë që i kërkuan Hilmi Pashës (inspektorit të përgjithshëm të Rumelisë) njohjen zyrtare të kombësisë shqiptare, të drejtën e mësimin dhe përdorimit të gjuhës shqipe, futjen e saj në ceremonitë fetare, emërimi i nëpunësve shqiptarë nga njerëzit e aftë, përdorimin e një pjese të taksave për ngritjen e shkollave, amnisti për të burgosurit, etj. Madje në 26 mars 1903 rreth 5000 kryengritës nën drejtimin e Ahmet Delisë, Ukë Kamberit etj., organizuan në Fushën e Morinës një kuvend, që hidhte poshtë reformat e Perandorisë të cilat rrezikonin tërësinë e trevave shqiptare dhe kërkonte dëbimin e konsullit rus Shçerbinit nga Mitrovica.

Në pranverën e vitit 1906 Drenica ishte përsëri në kryengritje, dhe ia arriti të ndalonte vjeljen e taksave të reja. Shemsi Pasha e Hasan Beu u hakmorën në gusht duke qëlluar fshatrat me artileri, por në 1907, Drenica ngriti përsëri krye për të kundërshtuar taksat e rënda dhe administratën osmane. Në shkurt 1907 krerët e Drenicës dhanë besën në një kuvend të organizuar në Junik për të bashkëvepruar me krahinat e tjera kundër dhunës dhe keqqeverisjes së autoriteteve osmane.

Më 1910 Drenica nën komandën e Isa Boletinit iu kundërvu forcave të Shefqet Turgut Pashës. Ata zunë Grykën e Carralevës dhe luftuan fort deri në shtypjen e kryengritjes, por Drenica ishte dhe mbeti mbështetja e padiskutueshme e çdo lëvizjeje kryengritëse. Më 5 maj

1912 mbërriti në Drenicë Hasan Prishtina. Ai udhëtoi posaçërisht nga Shkupi për organizimin në vend të kryengritjes. Në zemër të Drenicës, në Prekaz, ai pati mbështetjen e të mirënjohurit Ahmet Delisë. Në kryengritjen e 1912, Ahmet Delia ose Ahmet Prekazi, siç shënohet në disa dokumente, llogaritej ndër udhëheqësit kryesorë, që në krah të Hasan Prishtinës, Isa Boletinit, Zejnulla Vuçiternës, Xhemal Prishtinës etj., sulmuan nga Drenica drejt Mitrovicës, Vushtrrisë dhe Prishtinës.

Se çfarëburri ishte, Ahmeti e tregoi kur Serbia, në rrjedhën e Luftës Ballkanike, disa muaj më pas, pushtoi Kosovën dhe filloi operacionin e spastrimit etnik përmes dhunës, shpronësimit dhe shpërnguljes së shqiptarëve. Ahmeti me të birin Murselin u përleshën me ushtarët e çetnikët serbë, që po përpiqeshin të grabisnin e dhunonin familjen e një bashkëfshatari. Në këtë përleshje Ahmeti dha jetën, kurse Murseli më vonë do të ishte pjesëtar i çetës së famshme të Azem Galicës.

Drenica nuk do ta ndërpriste rezistencën as më pas. Ajo mori pjesë në kryengritjen e vitit 1913 (me qendër në Dibër), në kryengritjen e 1914, në rezistencën e viteve 1916-1918, fillimisht nën drejtimin e Shaqir Smakës e më pas të Azem Galicë, Fazli Beranit etj., dhe megjithëse u derdh shumë gjak e ndodhën shumë shkatërrime (vetëm ushtria bullgare dogji 350 fshatra në Drenicë), në nëntor 1918 Drenica u vetë çlirua nga luftëtarët e saj. Gjenerali francez Bashle, vlerësoi Azem Galicën dhe luftëtarët e tij për aksionet në krahinë kundër forcave ushtarake austro-hungareze dhe për robërit e kapur në Rudnik (Runik), por Franca kishte interesa strategjike të kundërta me interesat jetike të shqiptarëve, të cilët ishin të destinuar të prisnin ditë të tjera të këqija. Franca ngriti nën drejtimin e dinastisë serbe të

Karageorgjeviqëve, Mbretërinë Serbo – Kroate - Sllovene, apo Jugosllavinë dhe Kosova edhe njëherë sipas vendimeve të Konferencës së Paqes së Parisit, sikurse më 1913, me vendimet e Konferencës së Londrës, do të duhej të ishte pjesë e saj.

Karageorgjiët dhe soldateska e tyre e dhunshme e rikthyer, nuk e pasivizuan Drenicën. Në 22 vjetët e ekzistencës së Mbretërisë Jugosllave nuk e thyen e nënshtruan kurrë Drenicën. Azem Galicasë bashku me qindra luftëtarë në një luftë shumëvjeçare, që kulmoi me një kryengritje të fuqishme më 1919, vijoi me krijimin e një zone të lire (“Arbana e Vogël”) më 1923-1924, dhe që u karakterizua nga aksione të pareshtura e të guximshme edhe pas rënies së Galicës, Mikushnicës e Lybavecit dhe vrasjes së prijësit të shquar më 1924, dëshmuar se Drenica do të ishte një kafshatë e pangrënshme për Serbinë.

Atë e terrorizuan por rezistoi, e shpronësuan por jo sa deshën, e shpërngulën dhe e kolonizuan, por nuk ja ndërruan dot përbërjen etnike të popullsisë, e çarmatosën por nuk e lanë dot pa armë, ia vranë burrat e shquar, por nxori burra të tjerë, dhe në fund të Luftës së Dytë Botërore, në dimrin e viteve 1944-1945, e shtynë në një kryengritje shfarosëse, por ajo qëndroi edhe më tej për të përgatitur brezin që do të guxonte të përgjakej përsëri për lirinë.

Binte një Shaban Polluzhë, binin dhjetëra mijëra bashkëluftëtarë të tij, por Drenica vijonte të jetonte, përpiquej të rikuperonte humbjet, të rezistonte me mjete legale dhe ilegale, përpiquej të shkollonte brezin e ri, të mbante lart te ai edhe frymën patriotike dhe traditën e mosnënshtrimit. Dhe ja arriti që gjeneratat e reja të ishin gjithnjë në ballë të ballafaqimeve të mëdha që do sillte koha, më 1968, më 1981, më 1988-1989 e më pas. Prandaj, kjo vatrë patriotike, që s’ju shua kurrë zjarri, nuk e kishte rrufe në qiell të kthjellët, të bënte sërish akte të

mëdha, akte të pashembullt heroizmi, të luftonte, jo thjesht të guxonte të shkruhe një pushkë për hakmarrje, por të luftonte fort e me besimin se edhe në Evropën e fund shekullit të XX, mund të bëhet luftë çlirimtare kur ke zemër, kur ke të drejtë, kur je i gatshëm të sakrifikosh, kur je në gjendje të dëshmosh përpara botës të drejtën tënde dhe ta nxjerrësh para saj pa maskë pushtet mbajtësin e huaj terrorist.

Adem Jashari, gjithë familja Jashari, kontribuan në ekstrem për këtë, për të forcuar besimin dhe bashkimin mbarëkombëtar, për t'i dhënë mundësinë Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të ngrinte në këmbë një armatë të zgjedhur çlirimtarësh, që qenë të aftë të bindnin botën për drejtësinë e luftës së tyre dhe të aftë të siguronin aleancën e faktorit ndërkombëtar, duke realizuar aspiratën shekullore mbarëpopullore, lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, për të synuar më tej caqe të reja, së pari demokratizimin dhe integrimin e saj në familjen evropiane me të drejta të plota, si edhe hap pas hapi, prosperitetin e duhur për një popull që e meriton një të ardhme të lumtur.

Burimet e shfrytëzuara

BAJRAMI, Hakif - *Si e okupoi Serbia Kosovën më 1918*, Prishtinë, 2012.

ÇITAKU, Ibrahim - *Azem Galica dhe veprimtaria luftarake e çetave kaçake të Drenicës*, Prishtinë: Grafprint, 1996.

DOBRA, Islam - *Lufta e Drenicës 1941-1945*, Prishtinë, 1995.

Fjalori Enciklopedik Shqiptar, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Vëllimi I, II, III, Tiranë: Kristalina 2008.

FRASHËRI, Kristo - *Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1881)*, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2012.

Historia e Popullit Shqiptar, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Vëllimi I, Tiranë: Toena 2002, Vëllimi II, Tiranë, 2002, Vëllimi III, Tiranë, 2007, Vëllimi IV, Tiranë, 2009.

HOTI, Izber - *Të dhëna të panjohura për Luftën e Dytë Botërore në Kosovë (1944-1945)*, Prishtinë, 1999.

Isa Boletini në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, Përmbledhje kumtesash, botim i Institutit të Historisë, Prishtinë, 2015.

KEÇMEZI, (Basha) Sabile- *Organizatrat dhe grupet ilegale në Kosovë (1981-1989)*, Prishtinë, 2003.

Komiteti “Mbroyta Kombëtare e Kosovës”, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë: 2004.

Kosova në vështrim enciklopedik, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë: Toena 1999.

Kosovo- nekad i anas -Kosova dje dhe sot, Beograd, 1973.

KRASNIQI, Jakup- *Kthesa e madhe. Ushtria Çlirimtare e Kosovës*, Prishtinë, 2006.

NASI, Lefter - *Ripushtimi i Kosovës, shtator 1944-korrik 1945*, Tiranë, 1994.

PRIFTI, Kristaq - *Popullsia e Kosovës*, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë: Kristalina K.H, 2014.

RUSHITI, Limon - *Lëvizja Kaçake*, Prishtinë, 1981.

SHATRI, Muhamet - *Kosova në Luftën e Dytë Botërore*, Tiranë: Toena, 1997.

Shqipëria në dokumentet austro-hungareze, Vëllimi 1-7, botim i Institutit të Historisë, Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë: Kristalina, 2012.

Tafil Boletini, Kujtime, Tiranë, 2000.

VERLI, Marenglen - *101 Profile Biografike - Nga Kosova për Kosovën*, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë: Kristalina 2017.

VERLI, Marenglen - *Ekonomia e Kosovës nën vargonjtë e politikës jugosllave*, Tiranë: Mësonjëtorja e parë, 2000.

VERLI, Marenglen - *Shqipëria dhe Kosova, Historia e një aspirote*, Tiranë: Botimpex, 2007.